

Më  
Dana

03 - 05 - 2018

NË EMËR TË POPULLIT

  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në**  
përberje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri me procesmbajtësen Albënora Bekteshi, në çështjen  
penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Komuna Ferizaj, i akuzuar për shkak të veprës  
penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas propozim akuzës – kërkesës për  
dhënien e urdhrit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të evidentuar si: PP/II.nr.2229-  
4/17, të datë 11 dhjetor 2017, më 22 shkurt 2018 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj me kërkesë për shqiptimin e urdhrit  
ndëshkimor, të evidentuar si: PP/II.nr.2229-4/17, të datë 11 dhjetor 2017, dhe gjykata jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I pandehuri [REDACTED] nga fshati [REDACTED] – Komuna e Ferizajt, i lindur më [REDACTED] në  
të njëtin vend, nga i ati [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, pa të dhëna te tjera;

**Ë S H TË F A J T O R**

Sepse më datë 2 tetor 2017 rrëth orës 14:40, në pyllin të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi  
dhe Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, në rajonin ekonomiko pyjor Neredime – Jezercë në  
vendin e quajtur “Te Bashqet”, me qëllim vjedhje ka prerë 40 drunj të llojit ahu me diametër  
18cm, boniteti III, gjithsej në kubaturë prej  $4.40 \text{ m}^3$ , vlera e dëmit të shkaktuar është 673.20 €, të  
cilët drunj i ka bartur me qerre kuajsh,

- me të cilin veprim ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga nenit 358 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë shënuar dhe bazuar në dispozitën e nenit 4,7,17,21,41,42.43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 378 paragrafi 6 lidhur me paragafin 1 të KPRK-së të pandehurin:

### GJYKON

**DËNIM ME GJOBË** në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim sipas nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së, i njëjtë do i shndërrohet në dënim burgimi, ashtu për çdo njëzet (20) € do t'i llogaritet një (1) ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë në Komunën e Ferizajt, t'ia paguajë shumën në vlerë prej gjashtëqind e shtatëdhjetë euro e njëzet centi (673.20) € në emër të dëmit të shkaktuar, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri obligohet të paguaj shumën në vlerë prej njëzet (20) €, si dhe shumën prej tridhjetë (30) € për programin për kompensimin e viktimave të krimtit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit të detyruar.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me propozim akuzën PP/II.nr.2229-4/17, të datë 11 dhjetor 2017, ka akuzuar të pandehurin [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të propozim akuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Me rastin e vlerësimit të provave materiale të bashkangjitura si në shkresat e lëndës si: fletëparaqitjen e rojës së pyjeve të datë 12 tetor 2017 me nr.702/17, kallëzimin penal me nr.702/17 të datë 16 tetor 2017 të Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari të Komunës së Ferizajt dhe procesverbalit që gjendet në shkresat e lëndët, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë.

Gjykata vlerëson se këto prova janë bindëse dhe të bazuara, të cilat vërtetojnë se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet me aktakuzën e Prokurorit të Shtetit.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria e Bujqësisë, Pyltarisë në Komunën e Ferizajt, t'ia paguajë shumën në vlerë prej gjashtëqind e shtatëdhjetë euro e njëzet centi (673.20) €, në emër të dëmit të shkaktuar, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Në bazë të nenit 450 të KPP-së, gjykata të akuzuari e obligoi që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimtit taksën në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL**

P.nr. 3112/17

Datë: 22 shkurt 2018

Procesmbajtësja:

Albënora Bekteshi

Gjyqtari,

Mustaf Tahiri



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, kësaj gjykate, në afat prej tetë (8) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

